

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË
KESHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 142 Datë 18/10/2017

PËR "MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT"

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ; nenit 39/1, pika 1 e ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 për "Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", (i ndryshuar); pikës 1 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.97, datë 03.02.2008 për "Procedurat e privatizimit të banesave shtetërore"; të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 për "Privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", dhe VKM-se nr.614 date 07.07.2015 "Per percaktimin e procedurave per privatizimin e banesave dhe objekteve te kthyer ne fond banese, me vendimet e organeve te njesive te qeverisjes vendore dhe te shtetit, ku jane sistemuar me strehim banore te pajisur me autorizim nga organet kompetente" me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kruje, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve të përcaktuara në listën e paraqitur më poshtë, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, per qytetaret si vijon.

Nr	Emër Mbiemër	Adresa
1	Fatmir Vath Karaj	Dukagjin I Ri , Adrsa Blloku nr 8 ,Thunmane
2	Shan Ded Zefi	Dukagjin I Ri ,Adresa blloku nr 8 , Thumane
3	Tomorr Lulaj	Lagja SMT ,Fushe-Kruje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KRUJË
KESHILLI I BASHKISË**

2. Ngarkohet struktura pergjegjese e privatizimit per pregatijen e procedures se privatizimit dhe Kryetari i Bashkisë , ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës së privatizimit.

Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Hysni CACA

